



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut

Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South



Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Nga: z. Bedri Hamza - Kryetar i Komunës së Mitrovicës së Jugut



OPŠTINA E KOSOVËS-REPUBLIKA E KOSOVË KOMUNA E MITROVICËS-OPŠTINA MITROVICA	
№ DA	490/05 - 0044025/20
Mr i fq./Grua	
Dita/D	02.07.2024
Seti	Mitrovicë - Mitrovica

PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2023

Nr	Komponenta e auditimit(kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë	Zyrtari/ët përgjegjës	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit	Komente
1	Çështja A1 - Mossigurimi i garancionit të performancës dhe orarit të pagesave	<p>Sipas Nenit 13 të Ligjit nr. 08/l-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023 parasheh "Për pagesën e paradhënies për projektet kapitale, kontrata duhet të përmbajë garancionin e performancës dhe orarin qartazi të përcaktuar të pagesave, e cila njëkohësisht parasheh punën që duhet kryer para se të bëhet secila pagesë".</p> <p>Te Kontrata Ndërtimi i QMF-së në Koshtovë faza e dytë me vlerë të kontratës 134,373€, si dhe te kontrata Ndërtimi QMF në Stanterg me vlerë të kontratës 119,996€, për këto projekte komuna kishte dhënë avansin 15% të vlerës së kontratave, por nuk ishte ofruar garancioni i performancës siç kërkohet me ligje, dhe orarin qartazi të përcaktuar të pagesave, për punën që duhet kryer para se të bëhet</p>	Kryetari duhet të sigurojë se për pagesat e bëra në paradhënie do të kërkoj sigurimin e garancionit e performancës dhe orarin e pagesave i cila njëkohësisht parasheh punën që duhet kryer.	Me fillimin e procedurave do të kërkohet garancioni dhe plani dinamik i projektit sipas kërkesave ligjore që burojnë nga ligji i Buxhetit, ligji i prokurimit, udhëzuesit dhe rregulloret.	Zyrtarët e QKMF-se dhe DSh-së	Qershor – Dhjetor 2024	<p>Në kërkesat e radhes per procedurar e prokurimit do të kërkojme që secila kontrat ku do te ketë avanc do të kërkojme edhe garancioni për të0</p> <p>Po ashtu secilit projekt kapital do ti bashkangjitet edhe plani i realizimit të pagesave dhe plani dinamik</p> <p>Për projektet e cekura ju njoftojmë se</p>

		<p>secila pagesa.</p> <p>Shkaku i ndodhjes së kësaj është mungesa e kontrolleve të brendshme nga zyrtarët përgjegjës, që me rastin e dhënies së avansit ti kërkohet operatorit ekonomik që ta sjellë garancionin e performancës.</p> <p>Mos sigurimi i garancionit të performancës për paradhënie dhe i orarit të përcaktuar të pagesave i cili parasheh punën që duhet kryer mundë të ndikoj që projekti të mos realizohet ashtu siç është paraparë.</p>					kanë perfunduar pa vonesa dhe pagesat janë realizuar nëkohe
2	Çështja A2 - Tejkalmi i kontratës publike kornizë	<p>Neni 54.15 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, parasheh “Kurdo që Autoriteti kontraktues nuk dine sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshët në baze të rëndësisë se secilës “kategori të shërbimeve” ose secilit "artikull" në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. në këto raste nuk vlen pragu apo tavani plus/minus tridhjetë përqind (30%). Në këto raste në hapje publike të ofertave lexohet çmimi total i poentuar (peshuar) i cili shërben vetëm për qellim të</p>	<p>Kryetari duhet të përmirësojë kontrollin për të siguruar që përmes menaxherit të kontratës do të bëhet mbikëqyrje e mirëfilltë e kontratave, dhe pagesat mos të bëhet nga certifikuesi pa u siguruar se janë respektuar të gjitha kushtet e kontratës.</p>	<p>Eshtë njoftuar stafi dhe menaxherët e kontratave për rritjen e kontrollit në punë dhe furnizime për kontratat që janë me sasi indikative dhe kontrata tjera në përgjithësi</p>	<p>Zyrtaret e QKMF-se dhe DSh-se Menaxherët e kontratave dhe mbikqyresit e drejtperdrejt te tyre</p>	<p>Qershor – Dhjetor 2024</p>	<p>Menaxhmenti i DSh-se dhe QKMF-se ka shtuar kontrollin e menaxhimit të kontratave që janë duke u realizuar në kuadër të Shëndetësisë</p> <p>Po ashtu ka kërkuar që asnjë kontratë mos të tejkalohe por të planifikohet</p>

	<p>vlerësimit të ofertave ndërsa kontrata lidhet me çmime për njësi dhe mund të realizohet deri në vlerë të parashikuar. Po ashtu neni 25 paragrafi 1.2 i Rregullës financiare nr. 01/2013 MF shpenzimi i parave publike parasheh " Çertifikuesi të siguroj që kushtet e zbatueshme të një kontrate publike të jenë përmbushur para regjistrimit të shpenzimit në SIMFK dhe autorizimit të pagesave".</p> <p>Komuna me datën 27.12.2021, kishte lidhur kontratë publike kornizë me çmim për njësi për "Furnizim me barna dhe material mjekësor për QKMF dhe AMF-të të ndarë në dy lloje. Vlera e parashikuar për lloj 1 ishte 465,000€. Sipas raportit të menaxherit të kontratës furnizimet e kryera për lloj 1 janë 588,791€, të cilat edhe ishin paguar. Pra totali i tejkalimit të kontratës është 123,791€ apo 26.6%.</p> <p>Kjo ka ndodhur për shkak se menaxheri i kontratës nuk kishte njohuri se kriteri +-30% nuk mund</p>					<p>me kohe per sasin dhe mjetet që do ti shpenzojme per të</p>
--	--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--	--	--	--	----------------------------------------------------------------

		të aplikohet tek ky lloj i kontratave.					
		Tejkalimi i kontratës ndikon në rritjen e shpenzimeve shtesë të paplanifikuara të parasë publike si dhe mund të ndikon në rritjen e obligimeve komunale.					
3	Çështja B1 - Keqklasifikimi i shpenzimeve	<p>Sipas nenit 18 pikës 3 të Rregullës financiare nr. 01/2013, shpenzimet duhet të regjistrohen në kode adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, neni 11 i UA 19/2009 për planin kontabël kërkon nga ZKA dhe ZKF që të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.</p> <p>Gjatë vitit 2023, nga thesari përmes përmbarimit dhe vendimeve gjyqësore ishin realizuar pagesa në vlerë 256,011€ nga kategori ekonomike jo adekuate. Prej tyre 192,938€ ishin realizuar nga kategoria e investimeve kapitale përderisa për nga natyra këto shpenzime i takojnë kategorisë mallra dhe shërbime, ndërsa 63,074€ ishin realizuar për kompensim kompensimin e pagave prej tyre 54,759€ nga</p>	Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet e nevojshme në bashkëpunim me MF-në që të gjitha pagesat të realizohen sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të shpenzimeve në PFV, në përputhje me planin kontabël të Thesarit.	Të zbatohet në përpikëri Rregulla financiare nr. 01/2013 si dhe U.A. 19/2009 që gjatë ekzekutimit të shpenzimeve të respektohet plani kontabël nga zyrtarët përgjegjës.	Kryetari i Komunës Drejtoria për Buxhet dhe Financa Zyrtari Kryesor Financiar Zyrtari shpenzues dhe Zyrtari Certifikues	Deri në Dhjetor 2024	Sa i përket keqklasifikimit të shpenzimeve të ekzekutuara nga Thesari, shihet qartë nga konstatimi i Auditorit se këtë mosrespektim të Rregullës financiare nr. 01/2013 si dhe UA 19/2009 e ka bërë Thesari gjatë ekzekutimit të pagesave direkte – Vendimeve të Gjykatës dhe Urdhrave Përmbarimor.

	<p>investimet kapitale ndërsa 8,315€ nga shpenzimet komunale.</p> <p>Kjo ka ndodhur për shkak të ekzekutimit të pagesave nga thesari pa dakordim me komunën sidomos pagesave që lidhen me obligimet nga kontrata kolektive.</p> <p>Keq klasifikimi i shpenzimeve ndikon në mbivlerësim/nënvlerësim të shpenzimeve në kategoritë përkatëse të shpenzimeve dhe në paraqitje jo të saktë të shpenzimeve në PFV.</p>						<p>Mendoj se këtë të gjetur ZKA duhet ta rekomandoj Thesarit, edhe pse është bërë ekzekutimi nga buxheti nga OB. Mitrovica e Jugut. Ndërsa, sa i përket Pagave kjo ka ndodhur për shkak të ndikimit të Kontratës kolektive (pasi e njëjta nuk është marrë parasysh nga Ministria e Financave gjatë planifikimit të buxhetit për vitet prej që ka dhënë implikime</p>
--	------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--	--	--	--	--	----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

							buxhetore nga Kontrata Kolektive.
4	Çështja C1 - Vonesa në pagesën e Obligimeve	<p>Sipas nenit 39.1 të ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP), Çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës.</p> <p>Nga mostrat e testuara kemi vërejtur se në pesë (5) raste faturat/obligimet në vlerë 102,149€ nuk ishin paguar brenda afatit kohorë ligjor prej 30 ditësh.</p> <p>Kjo ka ndodhur për shkak të funksionimit jo të mirë të kontrolleve të brendshme, si dhe buxhetit të pamjaftueshëm.</p> <p>Vonesat në kryerjen e obligimeve mund t'i shkaktojnë kosto shtesë komunës për shkak se ajo mund të përballlet me padi ku përveç vlerës së faturës duhet t'i paguaj kostot shtesë përfshirë kamatën, interesin dhe shpenzimet gjyqësore.</p>	Kryetari duhet të përmirësojë menaxhimin e fondeve për të siguruar që obligimet financiare kryhen në kohë dhe brenda afatit prej 30 ditëve, duke përfshirë hartimin e një analize të hollësishme buxhetore për të shmangur vonesat në pagesat e faturave.	Drejtoritë Komunale dhe zyrtaret përgjegjës do të kujdesen që të gjitha obligimet të paguhen brenda afateve ligjore dhe të kujdesen menaxheret e kontratave dhe njësitë kërkuese që mos ti pranojnë faturat pa kompletuar raportin e pranimit dhe vlerësimet nga komisionet adekuate.	Kryetari i Komunës Drejtoria e Financave Drejtoritë Komunal Menaxheret e kontratave	Në pjesën e mbetur të vitit 2024	Planifikimi i rrjedhjes së paras së gatshme për vitin buxhetor nga ana e drejtorive përkatëse do të ndikoj në ngritjen e performancës në shkurtimin e vonesave ndaj obligimeve financiare dhe kontraktuale.
5	Çështja A3	Neni 15 i Ligjit nr. 06/L-005 për	Kryetari duhet të	Drejtoria për	Kryetari i	Në pjesën e	Gjatë këtij viti

<p>- Mos verifikimi i gjendjes aktuale të pronave</p>	<p>Tatimin në Pronën e Paluajtshme parasheh që Komuna çdo vit duhet të kryejë veprime të inspektimit (verifikimit) për të paktën 20% e të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës.</p> <p>Komuna e Mitovicës kishte faturuar Tatimin në Pronë nga sistemi i Protax për 27,871 objekte dhe prona. Komuna në vitin 2023 kishte arritur të bëjë inspektimin (verifikimin) e vetëm 2,414 objekteve apo me pak se 9%.</p> <p>Mos verifikimi i pronave kishte ndodhur për shkak të mungesës së stafit në departamentin e tatimit ne pronë dhe mos ndërmarrjes së masave nga menaxhmenti për angazhimin e stafit shtesë për ta kryer këtë proces.</p> <p>Inspektimi i ulët i pronave, mund të rezultojë me informata jo të plota të pronës së tatueshme aktuale si dhe të ndikoj në vlerësim jo të saktë të të hyrave për tatimin në pronë.</p>	<p>sigurojë arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor.</p>	<p>Buxhet dhe Financa - Sektori i Tatimit mbi Pronë dhe zyrtaret përgjegjës do të kujdesen që të rekrutojn stafe të ri pasi që kjo është arsyeja kryesore d.m.th. mungesa e stafit që nuk është mundur të implementohet Neni 15 i Ligjit nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme parasheh që Komuna çdo vit duhet të kryejë veprime të inspektimit (verifikimit)</p>	<p>Komunës Drejtoria e Financave Drejtoritë Komunale Menaxherët e kontratave</p>	<p>mbetur të vitit 2024</p>	<p>do të fillohet me rekrutim të stafit më së të domosdoshëm për Sektorin e tatimit në pronë, pasi që edhe disa nga stafi aktual do të pensionohen.</p>
-------------------------------------------------------	------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	----------------------------------------------------------------------------------------------	-----------------------------	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

				për të paktën 20% e të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës.			
6	Çështja C2 - Mangësi në menaxhimin e të hyrave nga tatimi në pronë	<p>Ligji nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 11 pika 1 definon:” Zbritja për vendbanimin parësor- Personi fizik, i cili vendos deri më 30 nëntor të vitit, para vitit tatimor se njësia e objektit shërben si vendbanim parësor dhe e deklaron këtë në komunë apo gjatë fazës së inspektimit, i lejohet zbritja prej 15,000€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit. Po ashtu, Ministria e Financave përkatësisht Departamenti i Tatimit në Pronë ka njoftuar komunat për vendimin e marr për regjistrimin e numrit personal në rastin e zbatimit të nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-005, kjo me qëllim të shmangies së duplikimeve/apo parregullsive dhe sigurimin e zbatimit efektiv të këtij neni.</p> <p>Nga analiza e data bazës qe i kemi bërë për tatimin në pronë të</p>	Kryetari duhet të marrë veprime shitesë për të siguruar se janë bërë korrigjimet e nevojshme në data bazën e tatimit në pronë, në mënyrë që zbritja për vendbanim parësor të bëhet vetëm për personat fizik të cilët janë të regjistruar me numër personal dhe kanë deklaruar në komunë se objekti shërben si vendbanim parsor.	Sektori i Tatimit ne Prone do të angazhohet qe te menaxhoj të hyrat nga tatimi në pronë si dhe do ta respektoj vendimin e marr për regjistrimin e numrit personal në rastin e zbatimit të nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-005, kjo me qëllim të shmangies së duplikimeve/	Kryetari i Komunës Drejtoria për Buxhet dhe Financa Sektori i Tatimit në pronë	Dhjetor 2024	Sektori i Tatimit ne Prone ne koordinim me DTP ne kuadër te MFPT ka konstatuar qe kjo ka ndodhur si pasoje e gabimeve teknike gjate gjenerimit te Raportit nga sistemi ProTax, sistemi ky qe menaxhohet nga DTP.

	<p>siguruar nga komuna, kemi vërejtur se zbritja ishte aplikuar tek 1,010 prona të cilat nuk ishin të regjistruara dhe nuk figuronin në sistem si vendbanim parësor, si dhe;</p> <p>Në pesë (5) raste nga mostrat e testuara ishte aplikuar zbritja për pronat personave që nuk kishin të evidentuar numrin personal. Po ashtu, nga analiza e data bazës për tatimin në pronë të siguruar nga komuna, kemi vërejtur se 2022 personave iu ishte bërë zbritja pa numër personal.</p> <p>Kjo ka ndodhur për shkak të funksionimit jo të mirë të kontroleve në departamentin e tatimit në pronë.</p> <p>Vlerësimi i njësive rezidenciale me zbritje pa numër personal, dhe pa deklaram se vendbanimi i tatimpaguesit shërben si vendbanim parësor, mund të rezultojë me kalkulim të parregullt të zbritjes apo shmangie nga tatimi në pronë, ku për pasojë komuna pranon më pak të hyra nga kjo kategori. Për më tepër, regjistrimi i numrave personal rrit efikasitetin, garanton informata më</p>		<p>apa parregullsi dhe sigurimin e zbatimit efektiv të këtij neni.</p> <p>Sektori i Tatimit në pronë do të njoftojë të gjitha palët përmes njoftimeve publike që të bëjnë përditësimin/plotësimin e të dhënave të tatimpaguesve.</p>			
--	-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--	--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--	--	--

		të sakta dhe të besueshme në regjistrin e tatimit në pronë.					
7	Çështja B2 - Inventarizimi i plotë i pasurive	<p>Rregullorja MF Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare të Organizatave Buxhetore përcakton në mënyrë të qartë mënyrën se si duhet të bëhet inventarizimi i pasurisë.</p> <p>Komuna kishte themeluar komisionin për inventarizimin e pasurisë dhe i njëjti e ka hartuar një raport të inventarizimit ku janë përfshirë pasuritë me vlerë nën 1,000€ të drejtorive komunale dhe disa institucioneve komunale, por jo edhe ato të shkollave dhe institucioneve shëndetësore.</p> <p>Kjo ka ndodhur si pasojë e mos zbatimit të plotë të kërkesave të rregullores për menaxhimin e pasurive, dhe mungesës së kontrolleve të brendshme.</p> <p>Mos përfshirja e të gjitha pasurive në procesin e inventarizimit i pamundëson zyrtarit të pasurive krahasimin/ harmonizimin e regjistrave të pasurive me raportin e inventarizimit dhe për pasojë mund të sjellë deri te mungesa e korrigjimeve eventuale të</p>	Kryetari duhet të sigurojë që komisionet e caktuara për inventarizim, të përfshijnë të gjithë pasurinë e komunës.	QKMF-ja ka të krijuar komisionin për inventarizim	DSH QKMF DKA	Janar – Dhjetor 2024	QKMF-ja ka të krijuar komisionin për inventarizim dhe ka të përpiluar raportin për secilin institucion të tij që e menaxhon

		regjistrave.					
8	Çështja B3 - Sfidat në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme	<p>Sipas nenit 26 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme 06-L 005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove dhe neni 27 Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjohën Arkëtimi i të hyrave tjera duhet të bëhet sipas afateve kohore të përcaktuara në faturë apo rregullore për secilin lloj të të hyrave.</p> <p>Komuna nuk po arrin të krijojë mekanizma për zvogëlimin e Llogarive të Arkëtueshme të cilat kanë arritur vlerën totale në 14,564,307€.</p> <p>Sfida kryesore mbetet inkasimi i tatimit në pronë që në vitin 2023 ka arritur vlerën prej 8,963,983€, të hyrat nga tarifat komunale në vlerë 2,025,452€ dhe të hyrat nga mbeturinat në vlerë prej 2,161,864€ etj.</p> <p>Nga gjashtë (6) mostra të testuar të qiradhënies së pronave komunale kemi vërejtur se qiradhënësit</p>	Kryetari duhet të adresojë problemet e lartpërmendura duke ndër marrë masa ligjore ndaj borxhlinjve sipas kushteve të dakorduara, të trajtohen kontratat e skaduara sipas procedurave të parapara.	Drejtorite përkatëse do të angazhohen në analizimin e detajuar të listave dhe në shpërndarjen me kohe tek të gjithë borxhlinjtë faturat e borxheve të grumbulluara . Pas kalimit të afateve të parapara ligjore për pagese do të ju dërgohen njoftimet përfundimtar e dhe do të iniciohen procedura përmbarimore.	Kryetari i Komunës Drejtoria për Buxhet dhe Financa DKRS Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Prone Drejtoria e Urbanizimit Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm Drejtoria për	Gjatë vitit 2024	

		<p>shfrytëzojnë pronat me kontrata të skaduara deri në 10 vite, dhe nuk i kanë përmbushur detyrimet sipas marrëveshjeve kontraktuale. Komuna gjatë vitit 2023 kishte dërguar tek përmabruesi 33 raste për arkëtimin e llogarive të tatimit.</p> <p>Rritja e LLA ka ardhur për shkak të veprimeve të pamjaftueshme të Komunës në drejtim të inkasimit të borxheve, neglizhencës së stafit dhe mos përcaktimit të saktë të personave/departamenteve përgjegjëse për menaxhimin e kontratave të qirasë.</p> <p>Mungesa e veprimeve të mjaftueshme apo mangësitë në procesin për arkëtimin e LLA, mund t'i dekurajojnë tatimpaguesit tjerë që t'i paguajnë obligimet e tyre me kohë. Për më tutje, mos realizimi i të hyrave të planifikuara, rritë rrezikun e dështimit të projekteve të planifikuara nga burimet vetanake.</p>			Pylltari dhe Inspektion		
9	Çështja B4 - Zbatimi i ulët i rekomandimeve të NJAB-së	Sipas udhëzimit administrativ nr. 01/2019 për themelimin dhe funksionimin e komitetit të auditimit për sektorin publik, neni 7, paragrafi 1.7 thekson se Komiteti i auditimit shqyrton	Kryetari duhet të sigurojë se rekomandimet e dala nga auditimi i brendshëm do të përcillen me një	Drejtoritë Komonale të cilat kane qene pjese e auditimit te brendshëm	Kryetari i Komunës Drejtoritë Komonale	Në vazhimsi	

	<p>raportet përmbledhëse, gjetjet, rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe siguron që ato janë adresuar siç duhet nga udhëheqësi i subjektit të sektorit publik.</p> <p>Nga vlerësimi i zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga NjAB është vërejtur zbatim i ulët i rekomandimeve. Nga gjithsejtë 32 rekomandime të dhëna vetëm nëntë (9) rekomandime ishin zbatuar, gjashtë (6) ishin në proces dhe 17 ishin të pazbatuara.</p> <p>Mos implementimi i rekomandimeve të NjAB-së ndikon në përsëritjen e gabimeve dhe dobësive të identifikuara nga auditimi i brendshëm.</p> <p>Mos implementimi i rekomandimeve të NjAB-së ndikon në përsëritjen e gabimeve dhe dobësive të identifikuara nga auditimi i brendshëm.</p>	<p>plan veprimi për implementimin e tyre si dhe një proces formal të monitorimit dhe raportimit nga njësitë përgjegjëse dhe të njëjtat rishikohen në mënyrë periodike për të parë progresin e zbatimit të tyre.</p>	<p>do të përgatitin planet e tyre të zbatimit të rekomandimëve të auditimit të brendshëm dhe do të kujdesen të kenë kontakte të vazhdueshme për implementimin e këtyre rekomandimëve.</p>	<p>Zyra e Auditorit të Brendshëm</p>		
--	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--------------------------------------	--	--